



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 30 maj 2024
Nr. ref.:RK 2434/24

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI90/22

Parashtrues

Jusuf Nikçi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë të
Aktgjykimit ARJ-UZVP.nr. 2/2022, të datës 10 mars 2022, të Gjykatës Supreme
të Kosovës;**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar dhe
Enver Peci, gjyqtar
Jeton Bytyqi, gjyqtar.

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Jusuf Nikçi, me vendbanim në Prishtinë, i përfaqësuar me autorizim nga Mehdi Geci, avokat në Prishtinë (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston: (i) Aktgjykimin [ARJ-UZVP.Nr.2/2022] e 10 marsit 2022 të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Supreme), në lidhje me Aktgjykimin [AA. Nr. 248/2021] e 11 nëntorit 2021, të Gjykatës së Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata e Apelit) dhe Aktgjykimin [A. Nr. 325/2019] të 28 dhjetorit 2020, të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Themelore).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, përmes të cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin në vijim: Kushtetuta) në ndërlidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ) dhe nenin 1 (Mbrojtja e Pronës) të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës), dhe 47 (Kërkesa Individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe rregullin 25 (Parashtrimi i Kërkesave dhe Përgjigjeve), të Rregullores së punës së Gjykatës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).
5. Më 7 korrik 2023, Rregullorja e punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 01/2023, u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe hyri në fuqi 15 ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata Kushtetuese i referohet dispozitave të Rregullores së lartcekur. Lidhur me këtë, konform Rregullit 78 (Dispozitat kalimtare) të Rregullores së punës Nr. 01/2023, përjashtimisht, dispozita të caktuara të Rregullores së punës Nr. 01/2018, do të vazhdojnë të zbatohen në lëndët e regjistruara në Gjykatë përpara shfuqizimit të saj, vetëm nëse dhe për aq sa janë më të favorshme për palët.

Procedura në Gjykatë

6. Më 22 qershor 2022, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata).
7. Më 23 qershor 2022, Kryetarja e Gjykatës përmes Vendimeve [Nr. GJR.KI] dhe [Nr. KSH. KI90/22] caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi, gjyqtar raportues, dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Bajram Ljatifi (kryesues), Safet Hoxha dhe Radomir Laban (anëtarë).
8. Më 30 qershor 2022, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje të kërkesës i dorëzoi edhe Gjykatës Supreme.
9. Më 11 mars 2024, gjyqtari Jeton Bytyqi dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç' rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
10. Më 30 prill 2024, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues njëzëri, i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

Në lidhje me procedurën administrative

11. Nga shkresat e lëndës rezulton që, parashtruesi i kërkesës ka qenë i punësuar pranë Kuvendit të Kosovës [në tekstin e mëtejme: Kuvendi], fillimisht, në pozitën e shefit të sektorit për Buxhet dhe Financa, ndërsa, sipas kontratës me numër [65/2002] të marrëdhënies së punës, të datës 12 janar 2006, parashtruesi i kërkesës ishte caktuar në pozitën e Drejtorit Ekzekutiv Financiar, për afat kohor prej 3 (tre) viteve.
12. Më 17 janar 2007, Komisioni Disiplinor i Kuvendit të Kosovës, kishte marrë Vendim [K.D. Nr. 01-12-06] me të cilin shpalli fajtor – *ndër tjerësh*- parashtruesin e kërkesës, për shkak të shkeljeve të rënda disiplinore në vend të punës, përkatësisht keqpërdorimit të detyrave dhe autorizimeve zyrtare, me qëllim të përfitimit për vete dhe personat e tretë. Si pasojë e shkeljeve të rënda disiplinore, parashtruesit tëi kërkesës dhe të tjerëve, Komisioni Disiplinor i Kuvendit të Kosovës u kishte shqiptuar masën disiplinore ndërprerjes së Marrëdhënies së Punës.
13. Ndaj Vendimit të sipërpërmendur, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë pranë Komisionit të Ankesave të Kuvendit të Kosovës [në tekstin e mëtejme: Komisioni i Ankesave]. Ky i fundit, me anë të Vendimit [K.A – 01-2/2007] të 16 prillit 2007, refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës, me arsyetimin se vendimi i Komisionit Disiplinor (i) nuk ishte përfshirë në shkelje të dispozitave procedurale; (ii) kishte zbatuar në mënyrë të drejtë ligjin material dhe (iii) kishte vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike.
14. Parashtruesi i kërkesës, ndaj vendimit të Komisionit të Ankesave, paraqiti ankesë pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës [në tekstin e mëtejme: KPMSHCK].
15. Më 31 korrik 2007, KMPSCCHK-ja kishte nxjerrë Vendim [Nr.1687/07] me të cilin konstatoi se Kuvendi nuk kishte bërë shkelje procedurale gjatë zhvillimit të procedurës disiplinore dhe/apo procedurës ankimore, duke shtuar se parashtruesi i kërkesës nuk kishte paraqitur asnjë provë të re mbi të cilat do të dëshmohej pafajësia e tij apo arsyeshmëria e ankesës së parashtruar dhe rrjedhimisht, ankesën e parashtruesit të kërkesës e refuzoi si të pabazuar.

Në lidhje me procedurën penale

16. Më 28 shkurt 2008, paralelisht me ngritjen e padisë nga parashtruesi i kërkesës, e cila do të elaborohet në vijim, prokurori publik ngriti aktakuzë ndaj parashtruesit të kërkesës për shkak të dyshimit të bazuar se ky i fundit kishte kryer veprën penale të nxitjes për falsifikim të dokumenteve zyrtare dhe mashtrimit të rëndë në detyrë, të përcaktuara sipas Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës [në tekstin e mëtejme: Kodi i Përkohshëm Penal]. Në lidhje me këtë, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, gjeti fajtor parashtruesin e kërkesës për veprat penale të lartpërmendura, ashtu që e kishte dënuar me 3 (tre) muaj burgim, me kusht që për periudhën kohore 1 (një) vjeçare të mos kryente ndonjë veprë tjetër penale.
17. Në ndërlidhje me procedurën penale që po zhvillohej kundër tij, parashtruesi kërkesës, paraqiti ankesë pranë Gjykatës së Apelit. Me Aktgjykimin [P. Nr. 164/2008] të 5 majit 2014 të Gjykatës së Apelit, parashtruesi i kërkesës u lirua nga akuzat në lidhje me veprën penale mashtrim i rëndë në detyrë, ndërkaq edhe pse ai u gjet fajtor në lidhje me veprën penale nxitje e falsifikimit të dokumenteve zyrtare, vepra penale në lidhje

me nxitjen e falsifikimit të dokumenteve zyrtare, vetëm se i ishte nënshtruar parashkrimit absolut në kohën kur Gjykata Apelit shqyrtoi çështjen dhe vendosi mbi të, dhe si rrjedhojë, të gjitha çështjet penale kundër parashtruesit të kërkesës pushuan.

Në lidhje me procedurën gjyqësore lidhur me aktin e kontestuar

18. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës ngriti padi pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë [në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore], në lidhje me vendimin e KMPSHCK-së.
19. Më 23 maj 2015, Gjykata Themelore, me Aktgjykimin [A. Nr. 2200/15] aprovoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, me të cilin, anuloi vendimin e KMPSHCK-së dhe ktheu çështjen në rivendosje dhe rishqyrtim te ky autoritet, me arsyetimin se *'[...] organi i paditur, nuk e ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike, nuk ka zbatuar drejtë Ligjin për Procedurën Administrative dhe nuk ka zbatuar drejtë ligjin material, kur paditësit me vendimin e goditur në padi, ia ka refuzuar ankesën si të pabazuar dhe ka lënë në fuqi vendimet e organit të shkallës së parë.'*
20. Ndaj këtij Aktgjykimi, KPMSHCK-ja ushtroi ankesë pranë Gjykatës së Apelit, e cila me Aktgjykimin [AA. Nr. 224/2016] e 20 dhjetorit 2016, refuzoi atë si të pabazuar dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, duke konstatuar se *'Vendimi i atakuar nuk përmban përmbledhje të konstatimeve faktike [...]. Në Vendimin e organit të paditur KPMSHCK, përfshihen në mënyrë kronologjike shkeljet të cilat i ngarkohen se i ka kryer ankuesi, por nuk shtjellohen dhe individualizohen veprimet konkrete të ankuesit dhe cilat fakte i ka vërtetuar KMPSHCK [...].'*
21. Në procedurë të rivendosjes dhe rishqyrtimit, KMPSHCK-ja me Vendimin [A/02/215/2016] të 30 janarit 2017, hodhi poshtë si të palejueshme ankesën e parashtruesit të kërkesës, me arsyetimin se ishte e pasafatshme, pra, ishte paraqitur jashtë afatit të paraparë ligjor, duke iu referuar nenit 11 të Rregullores Nr. 2001/36 mbi Shërbimin Civil të Kosovës [në tekstin e mëtejme: Rregullore mbi Shërbimin Civil të Kosovës].
22. Parashtruesi i kërkesës, ngriti padi për iniciimin e konfliktit administrativ, kundër vendimit të lartcekur të KMPSHCK-së. Gjykata Themelore me Aktgjykimin [A. Nr. 412/17] të 14 majit 2018, aprovoi kërkesëpadinë e paditësit, përkatësisht parashtruesit, ashtu që i) anuloi të gjitha vendimet e përmendura më lart, ii) detyroi Kuvendin e Kosovës që parashtruesin e kërkesës ta rikthej në vendin e mëparshëm të punës dhe iii) në lidhje me kërkesën e parashtruesit për kompensimin e pagave, e udhëzoi që kërkesën e tillë ta realizonte në procedurë kontestimore.
23. Kuvendi i Kosovës, paraqiti ankesë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore. Gjykata e Apelit me Aktgjykimin [AA. Nr. 399/2018] të 27 dhjetorit 2018, aprovoi si të bazuar ankesën e Kuvendit të Kosovës dhe çështjen e ktheu për rishqyrtim dhe rivendosje në Gjykatën Themelore. Gjykata e Apelit duke vendosur në procedurë ankimore, kishte gjetur si në vijim:

'Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë nuk i ka marrë për bazë e as nuk i ka vlerësuar fare provat e ofruara nga i padituri sic është kontrata e punës në të cilën përcaktohet afatin kohor të sajë, e cila kontratë i ka përfunduar më datë 11.01.2009, që do të thotë se afati i kontratës së paditësit ka përfunduar me këtë datë dhe gjykata e shkallës së parë nuk e ka vlerësuar fare një fakt të tillë [...].'
24. Në procedurë të rivendosjes dhe rigjykitimit, Gjykata Themelore nëpërmjet Aktgjykimit [A. Nr. 325/19] të 28 dhjetorit 2020, sërish anuloi të gjitha vendimet e mëparshme dhe

detyroi Kuvendin e Kosovës, që në emër të pagave për kohën të cilën ai do të duhej të ishte në vend të punës, përkatësisht prej vitit 2007 deri në vitin 2009, t'ia paguaj parashtruesit shumën përkatëse. Ndërkaq, kërkesën e parashtruesit të kërkesës për kthimin në vendin e mëparshëm të punës, e kishte refuzuar si të pabazë.

25. Më 15 shkurt 2021, parashtruesi kërkesës paraqiti ankesë pranë Gjykatës së Apelit, në lidhje me Aktgjykimin [A. Nr. 325/19] e Gjykatës Themelore, dhe i njëjti theksoi se Gjykata Themelore në Aktgjykimin e sipërpërmendur nuk përmbante fare arsyetim në lidhje me faktet për kompensimin e pagave të parashtruesit të kërkesës, pas skadimit të afatit kohor të kontratës mbi marrëdhënien e punës, duke qenë se ajo do të vazhdohej sepse ai ka pasur performancë të shkëlqyer në punë dhe se do t'i vazhdohej detyrimisht marrëdhënia e punës sikurse të punësuarve të tjerë, mirëpo që shkak i vendimeve të kontestuara parashtruesit të kërkesës nuk i ishte vazhduar. Andaj, rrjedhimisht kishte parashtruar ankesë kundër Aktgjykimit të sipërpërmendur me pretendimet se i njëjti ishte përfshirë në (i) shkelje esenciale të dispozitave procedurale, (ii) konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe (iii) zbatim të gabuar të ligjit.
26. Gjykata e Apelit me Aktgjykimin [AA. Nr. 248/2021] refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, ku konstatoi se *"[...] sa i përket pretendimeve ankimore të palës së interesuar se aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 pika n) të LPK-se, për faktin se aktgjykimi i ankimuar ka të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet, si dhe i njëjti nuk ka fare arsye, apo në të nuk janë treguar fare arsyet për faktet vendimtare përmes të cilave gjykata e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit. Këto pretendime ankimore ky kolegji nuk i aprovoj, ngase të njëjtat i ka vlerësuar si të paqëndrueshme dhe të paargumentuara me prova konkrete të cilat do të gjenin mbështetje ligjore, dhe si të tilla janë pa ndikim në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse sipas vlerësimit të kësaj gjykate aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë."*
27. Së fundi, parashtruesi i kërkesës, pranë Gjykatës Supreme, parashtrroi kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor të Gjykatës së Apelit. Gjykata Supreme nëpërmjet Aktgjykimit [ARJ-UZVP.nr. 2/2022] të 10 marsit 2022, refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës sepse kishte gjetur se *"[...] pretendimet në kërkesën e paditësit dhe palës së interesuar për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësorë janë të pabazuara, sepse nuk kanë ndikim për vërtetim të ndryshëm të gjendjes faktike prej asaj që ka vërtetuar gjykata e shkallës së dytë. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, aktgjykimi i kontestuar së shkallës së dytë është i qartë dhe i kuptueshëm. Në arsyetim të aktgjykimit të kontestuar janë dhënë mjaft arsye mbi faktet vendimtare të cilat i pranon dhe kjo gjykatë. Gjykata vlerëson se ligji material është aplikuar drejtë dhe nuk është shkelur ligji në dëm të palës së interesuar."*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

28. Parashtruesi i kërkesës pretendon se përmes Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme atij i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 46 [Mbrotjtja e Pronës] dhe nenin 49 [E drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, si dhe nenin 1 të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ-së.
29. Në lidhje me këto pretendime, parashtruesi i kërkesës specifikon se është shkelur: (i) parimi i arsyetimit të vendimeve gjyqësore; (ii) pengimi i ushtrimit të profesionit të tij

në mënyrë të paligjshme; dhe (iii) shkelja e të drejtës së pronës për shkak të pengimit të ushtrimit të profesionit. Në vijim, parashtruesi i kërkesës specifikon se pretendimeve të tij të ngritura në kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm në Gjykatën Supreme, kjo e fundit nuk u ka dhënë përgjigje lidhur me shkeljen e paragrafit 1 të nenit 35 të Urdhëresës Administrative Nr. 2003/2 për zbatimin e Rregullores së UNMIKU-t Nr. 2001/36 për Shërbimin Civil [në tekstin e mëtejshëm: Urdhëresë Administrative për zbatimin e Rregullores së UNMIKU-t për Shërbimin Civil].

30. Sipas parashtruesit, gjykatat e rregullta, përkatësisht Gjykata Supreme: (i) *“Në aktgjykimin e kontestuar, kanë gjetur se vendimet i instancave përkatëse të Kuvendit të Kosovës (vendimi i komisionit disiplinor dhe vendimit i komisionit të ankesave) si dhe vendimi i KPMPSHCK-së [KMPK] për ndërprerjen e marrëdhënies së punës te parashtruesi të kësaj kërkesë, z. Jusuf Nikci, kanë qenë të paligjshme dhe si të tilla janë anuluar. Megjithatë, ato gjykata nuk kanë eliminuar efektin që aktet e kundërligjshme që janë anuluar kanë prodhuar dëm të vazhdueshëm të parashtruesi të kërkesës, gjegjësisht z. Jusuf Nikci. Për pasojë, parashtruesi i kërkesës nuk është zhdëmtuar asnjëherë për shkak se ka pësuar dëm material dhe moral nga vendimet që janë shpallur si jo ligjore, (ii) kanë legalizuar efektet e një akti administrativ jo ligjor, duke mos sanuar/eliminuar pasojat e tij.*
31. Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës pretendon se ai është ndëshkuar, rrjedhimisht, ka humbur vendin e punës për veprime dhe mosveprime për të cilat ai nuk ka pasur kompetencë ligjore t’i ndërmarrë, pra çështje për të cilat nuk ka qenë përgjegjës ai, por zyrtarë të tjerë.
32. Për më shumë, parashtruesi i kërkesës pretendon se kontrata e marrëdhënies së punës, duke iu referuar praktikës së përgjithshme që është ndjekur atë kohë, është bazuar në dy kritere, përkatësisht , përkatësisht: i) performanca e shërbyesit civil dhe ii) karakteri i vendit të punës. Andaj, sipas parashtruesit, ai kishte plotësuar të dy kushtet, duke qenë se kishte marrë vlerësim të lartë në lidhje me performancën e tij në punë si dhe ka qenë i promovuar ashtu që nga pozita e shefit të sektorit për Buxhet dhe Financa, kishte kaluar në pozitën Drejtor Ekzekutiv Financiar dhe si rrjedhojë, ka qenë shumë e pritshme që të njëjtit t’i vazhdohej kontrata e punës pas skadimit të afatit të kontratës që veçse ishte në fuqi.
33. Tutje, parashtruesi i kërkesës thekson se Gjykata Supreme nuk ka adresuar fare pretendimin e tij në lidhje me trajtimin jo të barabartë që i ishte bërë atij në raport me të punësuarit e tjerë të Kuvendit të Kosovës, marrë parasysh se shumicës së punëtorëve i është vazhduar kontrata mbi marrëdhënien e punës, kështu duke shkelur parimin e barazisë para ligjit.
34. Gjithashtu, parashtruesi pretendon se për shkak të mos-eliminimit të efekteve që kanë prodhuar vendimet e kundërligjshme, ai është privuar nga të ardhurat financiare, përkatësisht nga paga mujore dhe kontributet e tjera përkatëse. Në këtë kuptim, parashtruesi kërkesës thekson se *“[...] ka pasur pritshmëri legjitime për fitimin e të drejtës në të ardhurat personale, nga kthimi në vendin e tij të punës, përkatësisht vazhdimi i marrëdhënies së punës. [...] sidomos nga data 23.05.2016, kur Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, nxori Aktgjykimin [...] me të cilin aprovoi si të bazuar padinë [...] dhe anuloi vendimin e KPMPSHCK-së.*
35. Në vijim, parashtruesi i kërkesës pretendon se si pasojë e largimit të kundërligjshëm nga puna dhe sidomos pas vërtetimit të kundërligjshmërisë së vendimeve me të cilat atij i është ndërprerë marrëdhënia e punës, atij i është cenuar e drejta e ushtrimit të profesionit, përkatësisht ekonomistit. Më tutje, thekson se rasti i tij, përkatësisht largimi i tij nga puna për arsye të lartcekura kishe marrë vëmendje mediatike. Kjo

rrethanë, dhe fakti se ai në vazhdimësi ka kërkuar kthimin në vendin e punës, e kanë penguar atë që të themelojë marrëdhënie pune në përputhje me profesionin e tij të ekonomistit.

36. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga gjykata që të: (1) të shpallë kërkesën të pranueshme për shqyrtim të meritave të saj; (2) të konstatojë se aktgjykimi i gjykatës Supreme të Kosovës, ka shkelur nenet 31, 46 dhe 49 të kushtetutës, në ndërlidhje me nenet 6 dhe nenin 1 të protokollit 1 të KEDNJ-së; (3) të shpallë të pavlefshëm aktgjykimin [ARJ-UZVP.nr. 2/2022] të 10 marsit 2022, të Gjykatës Supreme.

Dispozita relevante Kushtetuese dhe Ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

*“1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.”*

Neni 46

[Mbrojtja e Pronës]

- 1. E drejta e pronës është e garantuar.*
- 2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.*
- 3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë ekspropriimin e pronës nëse ky ekspropriim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave ekspropriohehet.*
- 4. Kontestet që lindin nga akti i Republikës së Kosovës ose autoritetit publik të Republikës së Kosovës për të cilat pretendohet se përbëjnë ekspropriimin, do të zgjidhen nga gjykata kompetente.*

[...]

Neni 49

[E drejta e Punës dhe Ushtimit të Profesionit]

- 1. E drejta e punës garantohet.*
- 2. Secili person është i lirë të zgjedhë profesionin dhe vendin e punës.*

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6

(E drejta për një proces të rregullt)

“1.Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohej drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t’i ndalohej shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.”

[...]

Protokolli Nr. 1 i KEDNJ-së

Neni 1 (Mbrojtja e Pronës)

“1.Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.”

[...]

Rregullore e UNMIK-ut Nr. 2001/36 mbi shërbimin civil të Kosovës

KAPITULLI II – Shërbimi civil

Neni 2 Parimet udhëheqëse

2.1 Shërbimi civil do të udhëhiqet nga parimet e mëposhtme:

(a) Barazia: trajtim korrekt dhe i paanshëm i nëpunësve civilë dhe i të tjerëve në përputhje me ligjin;

[...]

(e) Jodiskriminimi: nuk lejohet kurrfarë diskriminimi i drejtpërdrejtë apo i tërthortë në bazë të gjinisë, racës, ngjyrës, gjuhës, fesë, mendimit politik, prejardhjes kombëtare, etnike apo sociale, lidhjes me ndonjë komunitet nacional, pronës, lindjes, paaftësisë fizike, statusit familjar, shtatzanisë, orientimit seksual apo moshës.

[...]

Neni 3 Kushtet e punësimit

3.1 Dispozita të hollësishme mbi procedurat e punësimit dhe kushtet e punësimit për nëpunësit civilë do të parashtrihen në një urdhëresë të mëtejme administrative. Urdhëresa e tillë administrative, në mes tjerash, do të përfshijë kushtet vijuese:

(a) Që vendet e lira të punës të publikohen gjerësisht në gjuhën shqipe dhe serbe;

(b) Që organet e punësimit të formojnë juri prej 3 apo më shumë personave, me pëfaqësim të barabartë të komuniteteve në Kosovë, për të shqyrtuar kërkesat për vendet e punës dhe për listën përfundimtare, intervistimin dhe seleksionimin e kandidatëve;

(c) Që punësimi në Shërbimin civil të rregullohet me anë të kontratave me shkrim të punësimit;

(ç) Organet e punësimit t’u sigurojnë nëpunësve civilë vlerësime me shkrim për kryerjen e detyrave në baza vjetore;

- (d) Të ruhet fshehtësia e shënimeve të personelit dhe nëpunësit civilë të gëzojë të drejtën e kontrollimit të shënimeve që kanë të bëjnë me ta;
- (dh) Sigurimi i tarifave të pagesës për punën jashtë orarit dhe ndalimi i punës së detyruar jashtë orarit më shumë se sa është paraparë për një javë;
- (e) Përcaktimi i të drejtave të pushimit të nëpunësve civilë, duke përfshirë të drejtën për llojet e mëposhtme të pushimit me pagesë: pushimi vjetor, pushimi për festa zyrtare, pushimi mjekësor, pushimi për shkaqe të aksidenteve ose sëmundjes profesionale, pushimi i lehonisë ose pushimi i atësisë dhe pushimi për raste të vdekjes në familje, si dhe e drejta e pushimit pa pagesë për shkak të paaftësisë fizike.
- (ë) E drejta e nëpunësve civilë për një mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm të punës.

3.2 Urdhëresa administrative do t'i saktësojë sjelljet e keqia për të cilat nëpunësit civilë mund t'u nënshtrohen procedurave disiplinore dhe masave të mundshme disiplinore që mund t'u shqiptohen.

3.3 Kontratat e punësimit në Shërbimin civil do të jenë për një periudhë kohore deri në tri (3) vjet dhe ato mund të vazhdojnë.

Urdhëresa Administrative Nr. 2003/2 mbi Zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/36 mbi shërbimin civil të Kosovës

Kapitulli VII - Shkeljet e sjelljes, Dënimet dhe Procedurat Disiplinore

Neni 30 Shkeljet e sjelljes dhe dënimet

30.1. Shkeljet e kodit të sjelljes klasifikohen si më poshtë:

- (a) Shkelja e kodit të sjelljes të Shërbimit civil të parapara në shtojcën e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/36;
- (b) Mospërfillja e detyrës;
- (c) Mospërmbushja e udhëzimeve të arsyeshme të dhëna nga udhëheqësi ose organi i punësimit;
- (d) Mungesa e paautorizuar nga puna;
- (e) Mashtrimi ose vjedhja;
- (f) Diskriminimi, ngacmimi i ndonjë nëpunësi tjetër civil a i ndonjë pjesëtari të shoqërisë në mënyrë të drejtëpërdrejtë apo të tërthortë për arsye të seksit, racës, ngjyrës, gjuhës, fesë, banimit, mendimit politik, kombëtar, etnik ose origjinës sociale, lidhjes me ndonjë bashkësi kombëtare, pronës, lindjes, paaftësisë, statusit familjar, shtatzanisë, orientimit seksual ose moshës;
- (g) Ngacmimi seksual i ndonjë nëpunësi tjetër civil i përkufizuar si sjellje fizike apo verbale e natyrës seksuale e cila shkel dinjitetin e femrës ose të mashkullit në punë e që është e padëshirueshme ose fyese për personin mbi të cilin bëhet, apo që bëhet si kushtëzim për punësim që krijon një ambient armiqësor, kërcënues ose rrezikues për atë person;
- (h) Sjellja jashtë vendit të punës e cila nuk është në përputhje me statusin e nëpunësit civil dhe e cila mund ta diskreditojë Shërbimin civil, duke përfshirë edhe lidhjen me individët apo organizatat e angazhuara në prostitucion, trafikim të njerëzëve ose në krimin e organizuar;
- (i) Mosdeklarimi ose deklarimi i rrejshëm lidhur me konfliktin e interesit dhe
- (j) Sjellja apo gjuha e dhunshme, kërcënuese ose fyese në vendin e punës.

30.2 Dënimet lidhur me shkeljet që kanë të bëjnë me sjelljet e parashtruara në nenin 30.1 mund të jenë si vijon:

- (a) Vërejtja me gojë;
- (b) Vërejtja me shkrim;

- (c) Ndalesë e rritjes së rrogës deri në një (1) vit;
- (d) Ulja e pozitës
- (e) Ndalim i avancimit deri në tre (3) vjet dhe
- (f) Ndërprerja e punës.

KAPITULLI IX – Përfundimi i punësimit

Neni 35 Përfundimi i punësimit

35.1 Punësimi në Shërbimin civil përfundon automatikisht:

- (a) Me rastin e vdekjes ose pensionimit të nëpunësit civil. Moshë mandatore e pensionimit të nëpunësit civilë është gjashtëdhjetë e pesë vjet (65);
- (b) Pas skadimit të kontratës së punësimit të nëpunësit civil;
- (c) Pas dorëheqjes me shkrim të nëpunësit civil që i dorëzohet udhëheqësit kadrovik të organit të punësimit. Nëpunësi civil duhet të njoftojë tridhjetë (30) ditë kalendarike përpara për dorëheqjen e tij. Periudha e njoftimit mund të shkurtohet ose të hiqet nëse nëpunësi civil dhe udhëheqësi kadrovik i organit të punësimit pajtohen për këtë. Në fund të periudhës së njoftuar të dorëheqjes, përfundon punësimi i nëpunësit civil;
- (d) Kur vazhdimi i punësimit të nëpunësit civil nuk është konfirmuar në fund të periudhës së stazhit.

35.2 Punësimin në shërbimit civil mund ta përfundojë organi i punësimit sipas vlerësimit të tij të lirë:

- (a) Si masë disiplinore për shkelje të rëndë të kodit të sjelljes në pajtim me kapitullin VII dhe
- (b) Për shkaqe mjekësore kur nëpunësi civil është i paafte t'i kryej detyrat për shkak të sëmundjes së gjatë ose paqftësisë së është vërtetuar nga një komision mjekësor dhe kur detyrat nuk mund të përshtaten në mënyrë të arsyeshme për t'ia përshtatur ndryshimeve shëndetësore a fizike të nëpunësit civil.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

- 37. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të parashikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
- 38. Në këtë drejtim, Gjykata u referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

Neni 113
[Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

- 39. Gjykata në vazhdim shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen më tutje në Ligj, përkatësisht me nenet 47, 48 dhe 49 të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47

[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individidi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48

[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49

[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht...”

40. Përkitazi me përmbushjen e kriterëve të lartcekura, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili e konteston kushtetutshmërinë e një akti të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [ARJ-UZVP. 2/2022] të 10 marsit 2022 të Gjykatës Supreme, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Në vijim, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës ka specifikuar të drejtat e garantuara me Kushtetutë, të cilat pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit; dhe kërkesën e ka parashtruar brenda afatit ligjor prej 4 (katër) muajve, siç parasheh neni 49 i Ligjit.
41. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në paragrafin 2 të rregullit 34 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Paragrafi 2 i rregullit 34 të Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të së cilave Gjykata mund të shqyrtojë kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Specifikisht, paragrafi 2 i rregullit 34 të Rregullores së punës përcakton që: *“Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, kur parashtruesi/ja nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij/saj.”*
42. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime *“të shkallës së katërt”*; (ii) pretendime që kategorizohen me një *“mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”*; (iii) pretendime *“të pambështetura apo të paarsyetuara”*; dhe në fund, (iv) pretendime *“konfuze dhe të paqarta”* (shih, rastet e GJEDNJ-së, [Kemachev kundër Francës](#), [Kërkesa nr. 17621/91](#), kategoria (i), [Mentzen kundër Letonia](#), [Kërkesa nr. 71074/01](#), kategoria (ii) dhe [Trofimchuk kundër Ukrainës](#), [Kërkesa nr. 4241/03](#), kategoria (iii); shih gjithashtu rastet e Gjykatës: [KI40/20](#), parashtrues [Sadik Gashi](#), Aktvendim për Papranueshmëri, i 20 janarit 2021; [KI163/18](#), parashtrues [Kujtim Lleshi](#), Aktvendim për Papranueshmëri, i 24 qershorit 2020; [KI21/21](#), parashtrues, [Asllan Meka](#),

Aktvendim për Papranueshmëri, i 28 prillit 2021, [KI107/21](#), parashtrues *Ramiz Hoti*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 21 tetorit 2021).

43. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht në vlerësimin nëse e njëjta është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata fillimisht do të rikujtojë esencën e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ) në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
44. Fillimisht, Gjykata thekson se thelbi i rastit ndërlidhet me kërkesën e parashtruesit të kërkesës për kthimin e tij në vendin e punës në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës rezulton që Komisioni Disiplinor i Kuvendit i kishte ndërprerë marrëdhënien e punës si rezultat i shkeljeve të rënda disiplinore, përkatësisht keqpërdorimit të detyrave dhe autorizimeve zyrtare, me qëllim të përfitimit për vete dhe personat e tretë. Pas ankesës përkatëse të parashtruesit të kërkesës, Komisioni i Ankesave në Kuvendin e Kosovës e kishte refuzuar të njëjtën dhe kishte vërtetuar vendimin e Komisionit Disiplinor. Në vijim, KPMSHCK konstatoi se Kuvendi nuk kishte bërë shkelje procedurale gjatë zhvillimit të procedurës disiplinore dhe/apo procedurës ankimore. Në procedurën e konfliktit administrativ, Gjykata Themelore aprovoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, me të cilin, anuloi vendimin e KPMSHCK-së dhe ktheu çështjen në rivendosje dhe rishqyrtim. Pas ankesës së parashtruar nga ana e KPMSHCK-së, Gjykata e Apelit e refuzoi të njëjtën si të pabazuar dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore. Në procedurë të rivendosjes dhe rishqyrtimit, KPMSHCK-ja hodhi poshtë si të palejueshme ankesën e parashtruesit të kërkesës, me arsyetimin se ishte e pasafatshme, pra, ishte paraqitur jashtë afatit të paraparë ligjor, duke iu referuar nenit 11 të Rregullores Nr. 2001/36 mbi Shërbimin Civil të Kosovës. Kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës e aprovoi Gjykata Themelore duke anuluar të gjitha vendimet e përmendura më lart, dhe duke e detyruar Kuvendin e Kosovës që parashtruesin e kërkesës ta rikthej në vendin e mëparshëm të punës. Ankesën e Kuvendit të Kosovës kundër vendimit të paratheksuar, Gjykata e Apelit e aprovoi si të bazuar duke theksuar se Gjykata Themelore nuk i kishte marrë për bazë provat e ofruara nga i padituri siç është kontrata e punës në të cilën përcaktohet afati kohor i kontratës që kishte përfunduar më datë 11 janar 2009. Në procedurë të rivendosjes Gjykata Themelore sërish anuloi të gjitha vendimet e mëparshme dhe detyroi Kuvendin e Kosovës, që në emër të pagave për kohën të cilën ai do të duhej të ishte në vend të punës, përkatësisht prej vitit 2007 deri në vitin 2009, t'ia paguaj parashtruesit shumën përkatëse. Ndërkaq, kërkesën e parashtruesit të kërkesës për kthimin në vendin e mëparshëm të punës e kishte refuzuar si të pabazë. Ankesën e parashtruesit të kërkesës kundër vendimit të Gjykatës Themelore e refuzoi si të pabazuar Gjykata e Apelit. Përfundimisht, edhe kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor e refuzoi si të pabazuar Gjykata Supreme, ndër të tjera duke theksuar që Kuvendi i Kosovës kishte pasur kontratë pune me parashtruesin e kërkesës prej 12 janarit 2006 deri më 11 janar 2009, dhe se punëdhënësi nuk mund të detyrohet që automatikisht të vazhdoj kontratën pas skadimit, pasi që e drejta në punë vlen për aq sa vlen kontrata.
45. Gjykata thekson se parashtruesi para Gjykatës i konteston vendimet e gjykatave të rregullta, duke pretenduar, në thelb (I) shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, që kanë të bëjnë me mos arsyetimin e vendimit gjyqësor; (II) shkelje të nenit 46 [Mbrotjtja e Pronës] të Kushtetutës, si dhe (III) pretendimet për shkelje të nenit 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës.

(I) Sa u përket pretendimeve për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje nenin 6 të KEDNJ-së

46. Gjykata rikujton që e drejta për një gjykim të drejtë përfshin edhe të drejtën për një vendim të arsyetuar. GJEDNJ sipas praktikës së saj gjyqësore, e cila pasqyron parimet bazë lidhur me administrimin e duhur të drejtësisë, ka vlerësuar se vendimet e gjykatave dhe tribunaleve duhet t'i theksojnë në mënyrë adekuate arsyet në të cilat ato bazohen. (shih rastet e GJEDNJ-së; [Tatishvili kundër Ruisë](#), kërkesa nr. 1509/02, Aktgjykimi i 22 shkurtit 2007, § 58; [Hiro Balani kundër Spanjës](#), kërkesa nr. 18064/91, Aktgjykimi i 9 dhjetorit 1994, § 27; dhe [Higgins dhe të tjerët kundër Francës](#), kërkesa nr. 134/1996/753/952, Aktgjykimi i 19 shkurtit 1998, § 42).
47. Përveç kësaj, përderisa GJEDNJ-ja gjithashtu ka konstatuar se autoritete gëzojnë liri të konsiderueshme në zgjedhjen e mjeteve të përshtatshme për të siguruar që sistemet e tyre gjyqësore të jenë në përputhje me kërkesat e nenit 6 (1) të KEDNJ-së, gjykatat e tyre duhet "t'i tregojnë me qartësi të mjaftueshme bazat që kanë shërbyer për nxjerrjen e vendimeve të tyre". (Shih rasti i GJEDNJ-së, [Hadjianastassiou kundër Greqisë](#), kërkesa nr. 12945/87, Aktgjykim i 16 dhjetorit 1992, paragrafi 33).
48. Në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së theksohet se funksioni thelbësor i një vendimi të arsyetuar është që t'u tregojë palëve se janë dëgjuar. Për më tepër, një vendim i arsyetuar i jep një pale mundësinë për t'u ankuar kundër tij, si dhe mundësinë e shqyrtimit të vendimit nga një organ i apelit. Vetëm duke dhënë një vendim të arsyetuar mund të ketë shqyrtim publik të administrimit të drejtësisë. (shih *mutatis mutandis*, rastet e GJEDNJ-së [Hirvisaari kundër Finlandës](#), kërkesa nr. 49684/99, Aktgjykim i 27 shtatorit 2001 paragrafi 30; [Tatishvili kundër Ruisë](#), kërkesa nr. 1509/02, Aktgjykimi i 22 shkurtit 2007, paragrafi 58; dhe [Suominen kundër Finlandës](#), kërkesa nr. 37801/97, Aktgjykimi i 1 korrikut 2003, paragrafi 37).
49. Megjithatë, edhe pse GJEDNJ pohon se neni 6, paragrafi 1, obligon gjykatat të japin arsyet për vendimet e tyre, ajo gjithashtu ka konstatuar se kjo nuk mund të kuptohet si kërkesë për përgjigje të hollësishme në çdo argument. (Shih rastet e GJEDNJ-së; [Van de Hurk kundër Holandës](#), Aktgjykim i 19 prillit 1994, § 61; [Higgins dhe të tjerët kundër Francës](#), kërkesa nr. 134/1996/753/952, Aktgjykimi i 19 shkurtit 1998, paragrafi 42).
50. Shkalla në të cilën zbatohet obligimi për të dhënë arsye mund të ndryshoj varësisht nga natyra e vendimit dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të rastit. (rastet e GJEDNJ-së; [Garcia Ruiz kundër Spanjës](#), kërkesa nr. 30544/96, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, § 29, [Hiro Balani kundër Spanjës](#), Aktgjykimi i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 27, dhe [Higgins dhe të tjerët kundër Francës](#), cituar më lart, paragrafi 42).
51. Për shembull, në hedhjen poshtë të një ankese, një gjykatë apeli mundet në parim, thjesht të miratojë arsyet për nxjerrjen e vendimit të gjykatës më të ulët. (Shih rastet e GJEDNJ-së [Garcia Ruiz kundër Spanjës](#), Aktgjykimi i 21 janarit 1999, § 26 dhe [Helle kundër Finlandës](#), Aktgjykimi i 19 dhjetorit 1997, §§ 59, 60). Autoriteti ose gjykata me e ulët duhet të japin arsye të tilla që t'u mundësojnë palëve që të shfrytëzojnë në mënyrë efektive çdo të drejtë ekzistuese të ankesës. (Rasti i GJEDNJ-së; [Hirvisaari kundër Finlandës](#), cituar më lart, paragrafi 30).
52. Megjithatë, GJEDNJ gjithashtu ka vërejtur se edhe pse gjykatat kanë liri të caktuar të vlerësimit në zgjedhjen e argumenteve në një rast të veçantë dhe në pranimin e provave në mbështetje të parashtrësive të palëve, një gjykatë vendore është e detyruar të justifikojë veprimet duke dhënë arsyet për vendimet e saj. (Rasti i GJEDNJ-së shih [Suominen kundër Finlandës](#), kërkesa nr. 37007/97, 1 korrik 2003 § 36).

53. Prandaj, përderisa nuk është e nevojshme që gjykata të merret me çdo pikë të ngritur në kontest t (shih gjithashtu [Van de Hurk kundër Holandës](#), Ibidem, § 61), argumentet thelbësore të parashtruesve të kërkesës duhet të adresohen. (Rastet e GJEDNJ-së [Buzescu kundër Rumanisë](#), kërkesa nr. 61302/00, Aktgjykimi i 24 majit 2005, paragrafi 63; [Pronina kundër Ukrainës](#), kërkesa nr. 63566/00, Aktgjykim i 18 korrikut 2006, paragrafi 25). Po ashtu, dhënia e një arsyeje për një vendim që nuk është mirë e bazuar në ligj, nuk do të përmbushë kriteret e nenit 6.
54. Në fund, Gjykata gjithashtu i referohet praktikës së saj gjyqësore ku ajo konsideron që arsyetimi i vendimit duhet të theksojë raportin ndërmjet konstatimeve të meritës dhe reflektimeve kur të merren parasysh provat e propozuara nga njëra anë, dhe konkluzionet ligjore të gjykatës nga ana tjetër. Aktgjykimi i Gjykatës do të shkelë parimin kushtetues të ndalimit të arbitraritetit në vendimmarrje, në qoftë se arsyetimi i dhënë nuk përmban fakte të vërtetuara, dispozitat ligjore përkatëse dhe marrëdhënien logjike midis tyre. (Gjykata Kushtetuese: rasti nr. [KI72/12](#), *Veton Berisha dhe Ilfete Haziri*, Aktgjykimi i 17 dhjetorit 2012, paragrafi 61, dhe nr. [KI135/14](#), *IKK Classic*, Aktgjykimi i 10 nëntorit, paragrafi 58).

a) *Aplikimi i parimeve të lartcekura në rrethanat e rastit konkret*

55. Referuar pretendimeve të ngritura në kërkesë, Gjykata rikujton se pretendimi kryesor i parashtruesit të kërkesës ndërlidhet me mungesën e arsytimit të aktgjykimeve të gjykatave të rregullta, përkitazi me pretendimin e tij për tu kthyer në vendin e punës në Kuvendin e Kosovës.
56. Fillimisht, në kontekst të trajtimit të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata u referohet pjesëve relevante të Aktgjykimit [A.nr. 325/2019] të 28 dhjetorit 2020, të Gjykatës Themelore, e cila arsyetoi si në vijim:

"Ndërsa, sa i përket kërkesës së paditësit për kthimin e tij në vendin e punës të mëparshëm apo në një vend tjetër ekuivalent, gjykata e refuzojë si të pabazuar, pasi që me nenin 35.1 B) të UA 2003/2 për zbatimin e Rregullores për Shërbimin Civil 2001/36 në mënyrë shprehimore është përcaktuar se: "Punësim; në Shërbimin Civil përfundon automatikisht pas skadimit të kontratës së punës të nëpunësit civil", që në rastin konkret nga kontrata e punës me numër 65/2002 e lidhur në mes të këtu palës së interesuar Kuvendi i Kosovës dhe këtu paditësit Jusuf Nikqi, gjykata vërtetojë faktin sa i njëjti ka pasur kontratë të punës me palën e interesuar nga data 12.01.2006 në kohëzgjatje deri me datën 11.01.2009. Nga kjo rrjedh se-asnjë dispozitë ligjore nuk e obligon organin punëdhënës, që automatikisht ta vazhdojë kontratën e punës pas skadimit ngase e drejta nga lëmia e punës zgjasin aq sa është afati i kontratës, e andaj bazuar në këtë, gjykata vendosi si në pikën IV të dispozitivit të këtij aktgjykimi."

57. Në ndërlidhje me çështjen e lartcekur, Gjykata në vazhdim u referohet pjesëve relevante të Aktgjykimit [Ac.nr. 248/2021] të 11 nëntorit 2021, të Gjykatës së Apelit, e cila arsyetoi:

"Kolegji i kësaj gjykate konsideron se këto pretendime ankimore janë të pa bazuara dhe të paqëndrueshme, ngase gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, kjo për faktin se sa i përket kërkesës së paditësit për kthimin e tij në vendin e punës të mëparshëm apo në një vend tjetër ekuivalent, gjykata e shkallës së parë me të drejtë e ka refuzuar si të pa bazuar, pasi që me nenin 35.1 B) të UA 2003/2 për Zbatimin e Rregullores për Shërbimin Civil 2001/36 është përcaktuar se "Punësimi në Shërbimin Civil përfundon automatikisht pas skadimit të kontratës së punës të nëpunësit civil", e që në rastin konkret kontrata

e punës me numër 65/2002 e lidhur në mes të këtu palës së interesuar Kuvendit të Kosovës dhe këtu paditësit Jusuf Nikqi, gjykata ka vërtetuar faktin se i njëjti ka pasur kontratë të punës nga data 12.01.2006, në kohëzgjatje deri me datën 11.01.2009. Andaj, nga kjo rrjedh se asnjë dispozitë ligjore nuk e obligon organin punëdhënës që automatikisht ta vazhdojë kontratën e punës pas skadimit, ngase e drejta nga lëmia e punës zgjat aq sa është afati i kontratës, andaj, bazuar në këtë gjykata e shkallës së parë ka vendosur sikurse në pikën IV të dispozitivit të aktgjykimit.”

58. Në fund, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [ARJ-UZVP.nr. 2/2022] duke refuzuar si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor të parashtruesit së kërkesës, lidhur me pretendimin e tij përkitazi me kthimin në vendin e punës, arsyetoi si në vijim:

“Sipas mendimit të kësaj gjykate, gjykatat e instancës më të ulët në mënyrë të drejtë dhe ligjshme kanë refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit që ka bërë me kthimin e tij në vendin e mëparshëm të punës, sipas kontratës së datës 12.01.2006, apo në ndonjë tjetër vend të punës ekuivalent me të mëparshmin, si dhe pjesën për kompensimin për pagat e papaguara, përfshirë edhe sigurimin pensional dhe tatimin përtej shumës së gjykuar të aprovuar si në pikën e III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, për periudhën prej 11.01.2009 deri në ditën e ekspertizës së kryer 30.11.2019. Në fakt, neni 35.1(b) UA 2003/2 shprehimisht përcakton se punësimi në shërbimin civil pushon pas skadimit të kontratës së punës, që në rastin konkret do të thotë se nga kontrata nr.65/2002 të lidhur në mes të Kuvendit - punëdhënësit dhe paditësit -punëpranuesit, rezulton se i njëjti ka pasur kontratë të punës me palën e interesuar prej 12.01.2006 deri më 11.01.2009. Pra, me asnjë dispozite ligjore nuk mund të obligohet punëdhënësi që automatikisht të vazhdojë kontratën pas skadimit të kontratës, pasi që e drejta në punë vlen deri atëherë sa vlen kontrata.”

59. Duke iu referuar Aktgjykimeve të gjykatave të rregullta, Gjykata vlerëson se të njëjtat në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe konkrete adresuan aspektet e rastit për sa i përket refuzimit të kërkesëpadisë së parashtruesit të kërkesës për kthim në vendin e punës. Gjykata vëren se gjykatat e rregullta kishin sqaruar në plotni që (i) kontrata në të cilën ishte i punësuar parashtruesi i kërkesës ishte kontratë me afat të caktuar (përfshinte periudhën prej 12.01.2006 deri më 11.01.2009); (ii) nuk kishte bazë ligjore për të pretenduar që e njëjta të vazhdohej automatikisht; dhe se (iii) e drejta në punë vlen për aq sa vlen kontrata.
60. Gjykata, bazuar në parimet e përgjithshme të GjEDNJ-së, siç janë elaboruar më lart dhe bazuar në arsyetimet e gjykatave të rregullta, vlerëson se në rastin e parashtruesit të kërkesës, gjykatat e rregullta kanë nxjerrë vendimet e tyre në përputhje të plotë me standardet e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Kjo për faktin se nga shkresat e lëndës është e qartë se vendimmarrja ishte e bazuar në prova të ndryshme, të mbështetur në dispozita konkrete ligjore dhe vlerësimet e ekspertëve. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se gjykatat e rregullta kanë përmbushur detyrimin e tyre kushtetues për të ofruar një arsyetim të mjaftueshëm ligjor përkitazi me kërkesat dhe pretendimet e parashtruesit të kërkesës. Për rrjedhojë, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës kishte përfituar nga e drejta për të pranuar vendim të arsyetuar gjyqësor, në pajtim me kërkesat e nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
61. Në lidhje me këtë, Gjykata e konsideron të rëndësishme të theksojë qëndrimin e përgjithshëm e parimor se “drejtësia” që garantohej përmes nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, nuk është drejtësi “substanciale”, por drejtësi “procedurale”. Në terma praktik dhe në parim, kjo drejtësi procedurale shprehet përmes procedurës kontradiktore, ku palët dëgjohen dhe vendosen në të

njëjtat kushte para Gjykatës (Shih, ndër të tjera, rastin e Gjykatës, [KI131/19](#), parashtrues *Sylë Hoxha*, Aktvendim për papranueshmëri i 21 prillit 2020, paragrafi 57; dhe [KI49/19](#), cituar më lart, paragrafi 55). Kjo më saktësisht nënkupton se palëve përgjatë një procedure të drejtë dhe të paanshme duhet: (i) t'u mundësohet zhvillimi i procedurës bazuar në parimin e kontradiktoritetit procedural; (ii) t'u ofrohet mundësia që gjatë fazave të ndryshme të procedurës të paraqesin argumente dhe dëshmi që ata i konsiderojnë të rëndësishme për rastin përkatës; (iii) t'u garantohet se të gjitha argumentet dhe dëshmitë që ishin të rëndësishme për zgjidhjen e rastit përkatës janë dëgjuar e shqyrtuar në mënyrë të rregullt nga gjykatat përkatëse; (iv) t'u garantohet se faktet dhe pretendimet ligjore në vendimet gjyqësore ishin shqyrtuar dhe arsyetuar hollësisht; dhe se, në përputhje me rrethanat e rastit, (v) t'u garantohet se procedurat, shikuar në tërësinë e tyre, ishin të drejta dhe jo arbitrare (Shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, cituar më lart, paragrafi 29; dhe rastin e Gjykatës, [KI131/19](#), cituar më lart, paragrafi 58).

62. Gjykata arrin në përfundim se në rrethanat e rastit konkret, parashtruesi i kërkesës nuk ka argumentuar se standardet dhe garantitë e mësipërme të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me të drejtën në vendim të arsyetuar nuk janë zbatuar. Parashtruesi i kërkesës edhe më tej mund të mos jetë i kënaqur me rezultatin e gjykimit të çështjes së tij, megjithatë, kjo pakënaqësi vetvetiu nuk mund të ngrejë një pretendim të argumentueshëm për shkeljen e te drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë (shih, rastin e GJEDNJ-së: [Mezotur-Tiszazuqi Tarsulat kundër Hungarisë](#), nr. 5503/02, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21).
63. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se ky pretendim i parashtruesit të kërkesës lidhur me vendimin e paarsyetuar gjyqësor është qartazi i pabazuar në baza kushtetuese, në përputhje me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe me rregullin 34 (2) të Rregullores së Punës.

(II) Sa u përket pretendimit për shkelje të nenit 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ-së

64. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës gjithashtu thekson që vendimi i kontestuar është nxjerrë në kundërshtim me të drejtat e garantuara me nenin 46 [Mbrotjtja e Pronës] të Kushtetutës, si rezultat i pamundësimin të realizimit të të ardhurave nga mos-kthimi i tij në vendin e punës. Pra, i njëjti kërkonte kthimin në vend të punës e me të edhe kompensimin e të gjitha pagave të cilat do t'i takonin në rast se atij do t'i vazhdohej kontrata mbi marrëdhënien e punës.
65. Gjykata rikujton se neni 46 i Kushtetutës, sikundër edhe neni 1 i Protokollit Nr. 1 (Mbrotjtja e Pronës) i KEDNJ nuk garanton të drejtën për fitimin e pronës (Shih rastet e Gjykatës: [KI201/18](#), me parashtrues *Selami Taraku*, Aktvendim për papranueshmëri i 1 nëntorit 2019, paragrafi 39; [KI83/18](#), me parashtrues *Ivica Milosevic*, Aktvendim për papranueshmëri i 17 tetorit 2019, paragrafi 41; Shih gjithashtu rastet e GJEDNJ-së: [Van der Mussele kundër Belgjikës](#), nr. 8919/80, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 23 nëntorit 1983, paragrafi 48; dhe [Slivenko dhe të tjerët kundër Letonisë](#), kërkesa nr. 73049/01, Aktgjykimi i 9 tetorit 2003, paragrafi 121).
66. Në këtë kuadër, Gjykata i referohet interpretimeve të GJEDNJ, ku vihet në pah se neni 1 i Protokollit Nr. 1 (Mbrotjtja e Pronës) i KEDNJ-së vlen vetëm për "zotërimet" ekzistuese të një personi (shih : [Marckx kundër Belgjikës](#), nr. 6833/74, Aktgjykimi i 13 qershorit 1979, paragrafi 50; [Anheuser-Busch Inc. kundër Portugalisë](#), nr. 73049/01, Aktgjykimi i 11 janarit 2007, paragrafi 64).

67. Parashtruesi i kërkesës më tej mund të pretendojë shkelje të nenit 46 të Kushtetutës vetëm për atë që vendimet e kontestuara kanë të bëjnë me "pronën" e tij; brenda kuptimit të kësaj dispozite "pronë" mund të jetë "pasuria ekzistuese", duke përfshirë edhe pretendimet në bazë të të cilave parashtruesi i kërkesës mund të pretendojë "prishmëri legjitime" që do të fitojnë gëzimin efektiv të ndonjë të drejte pronësore.
68. Por, sipas praktikës së GJEDNJ, nuk mund të thuhet se lind ndonjë "prishje legjitime" atje ku ekziston një kontest në lidhje me interpretimin e drejtë dhe aplikimin e së drejtës së brendshme dhe atje ku parashtruesit janë hedhur poshtë më pas nga gjykatat kombëtare (shih: *Kopecky kundër Sllovakisë*, nr. 44912/98, Aktgjykim i 28 shtatorit 2004, paragrafi 50).
69. Mirëpo që, Gjykata thekson se një pretendim kushtëzues që buron si shkak i mosplotësisimit të kushtit nuk përbën "pronësi" sipas qëllimit të nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ-së. Thënë ndryshe, nëse e drejta mbi diçka jetësohet vetëm nëse plotësohet një kusht specifik dhe ky kusht nuk përmbushet, atëherë ligjërisht nuk mund të posedohet mbi atë të drejtë. (shih rastet: *Kopecký kundër Sllovakisë*, cituar më lart, paragrafi 35; *Prince Hans-Adam II of Liechtenstein kundër Gjermanisë*, kërkesa nr. 42527/98, Aktgjykim i 12 korrikut 2001, paragrafi 83; *Gratzinger and Gratzingerova kundër Republikës Çeke*, kërkesa nr. 39794/98, Vendim i 10 korrikut 2002, paragrafi 69).
70. Gjykata, duke i trajtuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me parimet e lartpërmendura, vëren se parashtruesi nuk e ka arsyetuar në veçanti shkeljen e së drejtës së pronës dhe nuk i referohet konkretisht ndonjë prej parimeve të përmbajtura në nenin 46 të Kushtetutës, por konsideron se kjo e drejtë i është shkelur si pasojë e shkeljes së të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (nenit 31 të Kushtetutës) për sa i përket mos arsyetimit të vendimit gjyqësor lidhur me pretendimin e tij për kthimin në vend të punës e me të edhe kompensimin e të gjitha pagave të cilat do t'i takonin në rast se atij do t'i vazhdohej kontrata mbi marrëdhënien e punës. Kjo për faktin se, sipas parashtruesit të kërkesës, gjykatat e rregullta nuk kanë dhënë arsyetim të detajuar lidhur me çështjen e mos-kthimit në punë të tij, dhe në këtë mënyrë nuk kanë vendosur për aprovimin e kërkesëpadisë së saj.
71. Pa paragjykuar sqarimet e mësipërme, edhe sipas nenit 35.1, paragrafi b, të Urdhërësës Administrative për zbatimin e Rregullores së UNMIKU-t për Shërbimin Civil, parimisht, kontratat mbi marrëdhënien e punës lidhen për afatin kohor 3 (tre) vjeçar, dhe skadojnë pas përmbushjes së këtij afati. Në të kundërtën, ato edhe mund të vazhdoheshin por kjo duhet të kuptohet në dritën e rrethanave plotësuese të cilat do e mundësonin zgjatjen e saj, andaj mundësia për zgjatjen e saj nuk duhet kuptohet si detyrim automatik. Si pasojë e kësaj, Gjykata konsideron se rrethanat e rastit nuk i japin parashtruesit të kërkesës të drejtën pronësore mbi pagat që do t'i takonin nën supozimin se këtij të fundit, do t'i vazhdohej kontrata mbi marrëdhënien e punës, sipas qëllimit të nenit 46 të Kushtetutës dhe nenin 1 të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ-së.
72. Megjithatë, gjatë shqyrtimit të këtyre pretendimeve në kuadër të nenit 31 të Kushtetutës, Gjykata tashmë ka ardhur në përfundim se këto pretendime janë qartazi të pabazuara. Prandaj, Gjykata konsideron se në rastin konkret nuk dëshmohet se parashtruesi i kërkesës ka kërkesë të arsyetuar lidhur me shkeljen e të drejtës së pronës sipas nenit 46 të Kushtetutës.
73. Prandaj, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtëzuese, prandaj deklarohet e papranueshme, në pajtim me rregullin 34 paragrafi (2) të Rregullores së punës.

(III) Sa u përket pretendimeve për shkelje të nenit 49 të Kushtetutës

74. Në fund, Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës pretendon se në rrethanat e rastit konkret, Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme, është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive të tij themelore, të garantuara përmes nenit 49 të Kushtetutës.
75. Përkitazi me këto pretendime, Gjykata thekson se fakti i thjeshtë që parashtruesi i kërkesës nuk është e kënaqur me rezultatin e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme apo vetëm përmendja e neneve të Kushtetutës, nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse. (shih, në këtë kontekst, rastin e Gjykatës [KI136/14](#), Abdullah Bajqinca, Aktvendim për papranueshmëri, i 10 shkurtit 2015, paragrafi 33; dhe [KI49/19](#), cituar më lart, paragrafi 58).
76. Në lidhje me këtë, Gjykata thekson se parashtruesi i kërkesës nuk ka ofruar asnjë provë çfarëdo qoftë që dëshmon se atij i është penguar ushtrimi i profesionit të tij, pas mbarimit të kontratës mbi marrëdhënien e punës, për shkak se në lidhje me pengimin e ushtrimit të profesionit të tij gjatë periudhës kohore prej vitit 2007 deri në 2009, të njëjtit i janë kompensuar pagat dhe kontributet e tjera përkatëse si pasojë e largimit nga puna.
77. Megjithatë, në sfondin e këtij pretendimi të parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 49 të Kushtetutës, Gjykata po ashtu vë në dukje praktikën e saj gjyqësore ku është sqaruar se Kushtetuta përkufizon një standard që ngërthen garancitë dhe të drejtat për të punuar, mundësitë e punësimit dhe të sigurimit të kushteve të barabarta të punës pa diskriminim, si dhe të drejtën e zgjedhjes së vendit të punës dhe ushtrimit të profesionit në mënyrë të lirë, pa detyrime të dhunshme. Këto të drejta janë të rregulluara në mënyrë më specifike me ligjet e aplikueshme (shih, ndër të tjera, rastet e Gjykatës [KI46/15](#), me parashtruese *Zejna Qosaj*, Aktvendim për papranueshmëri i 20 tetorit 2015, paragrafi 26; [KI70/17](#), parashtrues *Rrahim Ramadani*, Aktvendim për papranueshmëri, i 8 majit 2018, paragrafi 48; dhe [KI115/19](#), parashtruese *Sadete Jusufi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 11 marsit 2019, paragrafi 65).
78. Gjykata thekson se pretendimi i parashtruesit të kërkesës për shkeljen e të drejtës në punë duhet kuptuar në dritën e interpretimit të mësipërm. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës, në rastin konkret, argumenton se atij i është cenuar e drejta në punë dhe ushtrim të profesionit, sipas kuptimit të nenit 49 të Kushtetutës.
79. Gjykata konsideron se vendimet e kontestuara të gjykatave të rregullta në asnjë mënyrë nuk e ndalojnë parashtruesin e kërkesës të punojë ose të ushtrojë profesionin. Si rrjedhojë, nuk ekziston asgjë në pretendimin e parashtruesit të kërkesës që do të arsyetonte konstatimin se janë shkelur të drejtat e tij kushtetuese të garantuara me nenin 49 të Kushtetutës.
80. Gjykata thekson se duke u bazuar në nenin 48 të Ligjit dhe paragrafët (1) (d) dhe (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës dhe praktikën e saj gjyqësore, ajo vazhdimisht ka theksuar se: (i) palët kanë detyrim që të qartësojnë saktësisht dhe në mënyrë adekuate të paraqesin faktet dhe pretendimet; dhe gjithashtu (ii) të dëshmojnë dhe në mënyrë të mjaftueshme të mbështesin pretendimet e tyre për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese (shih rastet e Gjykatës: [KI163/18](#), parashtrues *Kujtim Lleshi*, i cituar më lart, paragrafi 85).
81. Bazuar në si më sipër, Gjykata konsideron se pretendimet e parashtruesit të kërkesës janë pretendime "të pambështetura apo paarsyetuara", dhe rrjedhimisht, të

papranueshme siç është përcaktuar përmes nenit 48 të Ligjit dhe rregullit 34 (1) (d) të Rregullores së punës.

82. Përfundimisht, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës është e papranueshme, sepse pretendimet e tij: I. Përkitazi me shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 6 të KEDNJ-se bien në kategorinë e pretendimeve të "shkalles së katërt" dhe rrjedhimisht janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese ashtu siç është përcaktuar me rregullin 34 (2) të Rregullores së Punës; dhe II. Përkitazi me pretendimet për shkelje të nenit 46 janë pretendime qartazi të pabazuara në baza kushtetuese siç përcaktohet me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe rregullin 34 (2) të Rregullores së Punës; si dhe III. Përkitazi me nenin 49 të Kushtetutës, të njëjtat bien në kategorinë e pretendimeve "te pambështetura apo paarsyetuara", dhe rrjedhimisht, të papranueshme siç është përcaktuar përmes nenit 48 të Ligjit dhe rregullit 34 (1) (d) të Rregullores së punës.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, neneve 20 dhe 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 34 (1)(d), 34 (2) dhe 48 (1) (b) të Rregullores së punës, më 30 prill 2024, njëzëri:

VENDOS


- I. TË DEKLAROJË, kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË, këtë Aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË, këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 të Ligjit;
- IV. Ky Aktvendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtari raportues


Nexhmi Rexhepi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Gresa Caka-Nimani